



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 25.11.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Sami Bytyqi, anëtar
10. Fitim Shala, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Rinor Murati, anëtar
13. Armend Grajqevci, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Gentianë Hoxhaj, anëtare
16. Venhar Agushi, anëtar
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi Nënkyetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Anila Reçica, DKRS
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Shkelzen Hajdini, DSH
8. Flamur Sylejamani, DI
9. Elmaze Behluli, DA
10. Sead Aliu, DI
11. Rexhep Rexhepi, DBP
12. Rasim Hasani, DA
13. Safete Amerrlahu, DGJK
14. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 12-të e Kuvendit.
2. Informatë mbi punën e deritanishme të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, Janar-Tetor 2022.
3. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.
4. Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023.
5. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të ankesave.

Kryesuesi i kuvendit tha se i kemi edhe 2 pika shtesë ashtu si ju kam njoftuar edhe në KPF, e ku e keni pranë edhe materialin me kohë.

6. Propozim Rregullore për anulimin e rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15.Nr.351/06-59184 e datës, 31.10.2022
7. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Po ashtu tha e kam marrë edhe nje shkrese nga grupi i grave të LVV-së për një pike, raport të këshilit komunal koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore.

Përe shkak të afatve ligjore nuk kam mujtë me pru ne kete mbledhje pasi qe ka ardhe me vonesë, por do ta lojme ne mbledhjen e arshme dhe une do te ju dergoj kërkesë komisaionit nese ata janë të gatshë, pasi qe edhe ata kanë nevojë për kohë shtesë.

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Alban Salihu tha se ky arsyetimi se kërkesa ka ardhe me vonesë nuk është I qendrueshëm pasi qe egzekutivi shpesh here po bjen propozime pasi qe po e kemi rendin e ditës.Ndërsa kjo arsyeja e dyte mu pregadite qendron deri dikun, por ata ketë punë e kanë dhe kishin mujte me pregaditë.

Daut Azemi, tha se vendimet qe po na kthen ne kemi obligim ligjor prej 30 dieve per rishqyrtim, ndersa sa I perket ketij raporti duhet kohe qe te pregaditet pasi qe eshte nj ekomision prej disa perosnave

Po mundem edhe ne Kuvend me qit tash une kete pike dhe ju kuevndi vendosni nese kalon ose jo?

Rinor Murati, tha se jë raportim i tiull na ndihmon edhe neve si antëtar të Kuvendit, por ne emër të grupit të LDK-së, kërkojm qe te jetë edhe një raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit, nga stacioni policor.

Lulzim Rrustemi, tha se e para autorisa duhet me ju shku deputetëve sakt kush e ka ngrit. E dyta nuk e pash në rend të ditës Informatën e kërkuar nga DKA-ja, cila është arsyeja. Pse kërkesat tona nuk po I merr parasysh egzekutivi? Na nuk e kemi asnjë informatë per nivelin e arsimit? Dhe në plan të punës e kami pas informatën për arsimin në muajin shtator.

Daut Azemi, une do ta percjelli prap kërkesën dhe shpresojme qe ne mbledhjen e arshme qe do ta kemi informatën.

Arsim Jashari, tha se se i perket kerkeses per raport apo informatë ata e kan një afatn 15 ditor, ku duhet me na kthy nje pergjigje.

Daut Azemi, tha une do të bëjë kërkesë per te dy pikat në emër të anëtarëve të kuevdnit .

Meqë vërejtje tjera as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 31 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj, kryesuesi i kuvendnit tha se pari ia uroj komunës së Lipjanit çmimin si fitues i ekselencës, po ashtu edhe festën e 28 nëntorit dhe ju ftoj ne inaugurimin e objektit të ri të komunës.

Po ashtu tha se ju uroj 1 vjetorin e punës si anëtar te kuvendnit ku nesër e kemi 1 vjetorin e punës dhe gjatë këtij viti kemi pas gjithsej 101 pika te rendit të ditës deri ne mbledhjen e 12-te te kuvendnit dhe kemi miratuar gjithsej 76 akte, ne mesin e tyre edhe statutin e komunës së Lipjanit

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Daut Azemi, tha se pari e kemi një rekomandim te komitetit për komunitete edhe pse është pak me vonesë, dhe i falënderoj komitetet për punën qe po e bëjnë.

Shahadije Dragaëina ,tha se ne anëtarët e komitetit për komitete e kemi bërë një vizitë në Janjevë dhe tha se Rekomandimet për procedim te ekzekutivit komunal të projekteve të investimeve kapitale për Janjevë janë:

1. Riparimi i gypave në rrjetin e kanalizimit në lagjen e komunitetit rom
2. Investime në rrjetin e ujësjellësit në tërë fshatin
3. Asfaltimi i rrugës “Shtjefan Gjeqovi” dhe rrugës qe lidhë Janjeven me Tegen
4. Riparimi i rrugës “Saraj” e cila është e dëmtuar nga punimet rreth instalimit të ujësjellësit.
5. Investimet në rifunksionalizimin e Qendrës së Kulturës/Kinemasë e cila tashme po përdoret si shtëpi banimi.
6. Riparimi/pastrimi i shtratit të lumit të fshatit.

Gazmend Qerkini, tha se pari i uroj kryetarin dhe te gjithë qytetarët për çmimin e ekselencë, po ashtu pa harruar edhe çmimet tjera për mjedis te pastër po ashtu për transparencë, si nga organizata ndërkombëtare ashtu edhe nga ato vendore. Ku ne si anëtar te kuvendnit nga radhët e LDK-se, ndehemi krenar për punën qe po e bënë ekzekutivi.

Arsim Jashari, tha se edhe ne anëtarët e kuvendnit nga radhët e PDK-së, kemi votuar atë sondazh dhe ne votojmë për të mirën e vendit tonë. Ka një kërkesë të banorëve të fshatit Gllgovc, për trotuar po ashtu edhe për ndriçim publik pasi qe aty po rrezikohen qytetarët. Po ashtu po bëhet shumë punë e mirë objekti i ri i komunës por do të ishte mirë qe aty me qenë edhe flamuri i UÇK-së, pasi qe është edhe ditëlindja e komandantit legjendar Adem Jasharit. Një pyetje për drejtorin e shëndetësisë, renovimet qe kanë filluar ne QKMF, pse kanë mbet në gjysme. Dhe e kam një vërejtje për ekzekutivin, sa herë po ka ndonjë projekt i gjithë ekzekutivi i shkojnë mbrapa kryetarit në teren me 3-4 vetura e ku shumica nga ta nuk kanë të

bëjnë me aktivitetin, e ku ata paguhen nga taksat tona, ndërsa zyret e tyre mbetin te mbyllura ne komunë.

Alban Salihu, tha se edhe na e urojmë edhe këtë çmim por te dimë se çka kemi fituar pasi qe 12 komuna e kishin fituar këtë çmim. Pastaj tha se këto ditë bëhet 1 vjetori i fillimit të punës së kryetarit t

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Alban Salihu, tha se edhe na e urojmë edhe këtë çmim por te dimë se çka kemi fituar pasi qe 12 komuna e kishin fituar këtë çmim, Pastaj tha se këto ditë shënojnë njëvjetorin e rezultateve të zgjedhjeve të fundit komunale, me ç'rast Imri Ahmeti mori mandatin e radhës. Sot, do të ishte ideale sikurse të mos kishim asnjë problematikë a keqmenaxhim në qeverisjen e tij Pas një viti prej zgjedhjeve të vitit të kaluar, komuna e Lipjanit fatkeqsisht, vazhdon në gjendjen e njëjtë të mjegullisë, mungesës së projekteve të mirëfillta, që synojnë interesin e qytetarëve,pra kemi një qeverisje komunale të dobët, e një kryetar komune i cili aktivitetin kryesor e ka atë të partisë në nivelin qëndror. Avazi i njëjtë me punësime në sektorin publik. Mësimdhënës e drejtorë shkollash të punësuar në bazë të një kriteri: librezës partiake,punësimit të stafit shëndetsor, mjekë militantë partiakë, të cilët shpërblehen për favore gjatë fushatës, Poashtu jemi dëshmitarë se kryetari i Lipjanit ka refuzuar në shumë raste kërkesat për investime të jashtme në komunën tonë, siç është rasti konkret i refuzimit të kërkesës së Federatës së Futbollit të Kosovës për një investim të UEFA. Gjithcka që sot mund të thuhet për kryetarin e qeverisjen e tij, është tepër pak për ta përshkruar siç është. Qytetarët e komunës së Lipjanit janë ata të cilët nuk duhet të vuajnë pasojat e kësaj keqqeverisje. Ne garantojmë qytetarët, se zëri i tyre do të dëgjohet, çdoherë për të mirën e tyre.

Gazmend Qerkini, tha se i falanderoj te gjithë antarët e kuvendit dhe qytetarët për përkrahjen. Ne meritojmë ta lavdohemi sepse po i marrim te gjitha çmimet si komuna me e mirë.

Imri Semetishti, tha se se dola me dhënë një sçarim per fitimin e ekselences, dhe Këshilli i Evrpës ka dhënë një pytesor siaps 12 kriterëve per qeverisje te mirë në Kosovë.Ky projekt ju ka ofru te gjitha komunave dhe ne te kane hy vetëm 13 komuna, ku ky projekt është zhvillu edhe ne Kroaci dhe ne Maqedoni te veriut.Ka qenë 2 pjesë

dhe ne kemi dhë të gjithë shembujt real praktik gjatë qeverisjes. Janë vlersuar indikacionet për të cilat kemi punuar, dhe nemi në pozitën që kemi fituar çmimin me maksimal të pikëve në të gjitha kategoritë. Vlersimin e kanë bërë komisioni nga çmimi i Evropës. Me këtë kemi vlerë të akreditimit të programit.

Alban Salihu, tha se drejtori është shumë korrekt, por ka qenë shumë i egzagjeruar dhe nuk o një çmim që e ndryshon gjendjen në teren.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se ju pergjoj punën që keni bërë si kuvend, ne kemi fituar një akreditim për çmim në Europ ,nes si komunë jemi zgjedh si komuna me miqsore në BE. Po ashtu kemi pash bahskpunime dhe cmime nga Bashkimi Evropian.Me këtë kemi fituar një privilegj.

Albiona Tasholli, tha se sa më shumë që po kritikohet ekzekutivi dhe kryetari i komunës, aq më shumë po rritet perqindja e kanqësisë të qytetarët.

Fadil Spahiu, tha se i kam disa kërkesa e para ka të bëjë me drejtoratin për administratë,se une si anëtarë i komisionit të këshillave të fshatrave bazuar në rregulloren për këshillat e fshatrave dhe kërkesës së qytetarëve, kërkoj nga drejtorati i administratës që të respektohet rregullorja dhe të vendosen njoftimet në vendet me të frekuentuara.Kërkesa e dytë ka të bëjë me banorët e fshatit Gadime të cilët janë falenderues për punën të cilën e kanë bërë por kërkojnë që të vazhdohet shtegu i ecjes sepse pjesa e ndertuar ka filluar të dëmtohet një pjesën anësore.

Egzona Bytyq, tha se kam një pyetje për Drejtoratin e SHP, këtë muaj kemi pas reshje të shihut por fal Zotit në komunën tonë nuk kemi pas vërshime, cilat janë masat që ju si drejtori i keni marr që mos me pas probleme në të ardhmen me vërshimet. Pyetja e dytë, si e kemi gjendjen gjendjen me ujë me ato aktivitete që janë me ujësjellës. Dhe pyetja e fundit rreth rrugës për në rufc nga Lipjani pasi që aty është dëmtuar ura nga uji. Dhe një kërkesë të bëhet pastrimi i lumit në Qylagë.Dhe e fundit ditëve të fundit sportisti nga komuna jonë Betim Krasniqi,është shpall kampion i badibildingut kjo është krenari për neve dhe është mirë me i bërë ftesë që të jetë në inagurimin e objektit të komunës.

Armend Grajqevci, tha se edhe une e uroj ekzekutivin dhe kryetarin për çmimin e ekselencës. Kam një kërkesë të bëhet vendosja e ndihmave të para në hapsirat publike ku frekuentohen shumë nga qytetarët.

Besian Sylja, tha se une dua ta ngris një qeshtje rreth dukurive negative të cilat po ekspozohen nga të rinjtë lipjanas, ku qytetarë i përmendin Stacionin e autobusëve,

tregun e gjelbert dhe shtëpinë e kultures si trekendsh ku perdoren disa dukuri negative nga këta të rinjë. Këto raste duhet të minimizohen dhe une dua të di se çfar plane ka komuna per te zgjidhur këtë qeshtje dhe e ka bashkpunim me stacionin e policisë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se rekomandimi qe e bëri më heret, nuk mendoj qe është i vonshëm dhe mund te kryhen me ridestinin apo me rishikim. Pasi qe po inagurohet komuna e re është mirë qe grupet e asamblese me i pas zyret e veta. Kam pyetje për DKA-në, në gjimnaz po pritet te blihen uniforma nga nxensit, mirëpo ato janë vonuar është mirë ju si drejtor me ndiku pak. Kërkoj nga komuna qe te subencionoj për këto uniforma nga viti i ardhshëm. Tjetra para disa viteve ne vitin 2013,kur është dhën në shfrytzim prona UBT-së, ka qenë nje marrëveshje mes komunes se Lipjanit dhe drejtorit të UBT-se, per studentet e Lipjanit qe studjojnë të kenë 50% me lire pagesën për studime, por është shkëput njëanshëm ajo marveshje duhet te shikohet ajo marveshje qe te ju bëhet me lire studetve te Lipjanit.

Daut Azemi, kryesues i kuvendnit tha se si rekomandim është pak i vonshëm pasi qe tani janë kryer edhe dëgjimet buxhetore po ashtu edhe IKAP-i, e une ju pergzoj juve si komitete per punen qe po e beni. A do te ket ridestinin ose jo.

Rinor Murati, tha se une i kam dy kërkesa: vendosja e pjerrinave për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha institucionet e Komunës (pra, në ato vende që mungojnë pjerrinat) dhe Aktivizimi i Wi-Fi-së në këndin e leximit për studentët që e frekuentojnë Bibliotekën e Qytetit, gjë që lehtëson kërkimet e tyre dhe përgatitjet gjatë studimeve;

Ardit Cani, tha se ne si komitet per Kulture Rini dhe Sport, kemi pas disa vizita në teren dhe gjatë vizitës na janë drejtuar disa kërkesa si, rregullimi i pjerrinave per personat me nevoja të veçanta në qendren e kuturës nga Magure dhe në disa vende tjera. Në biblotekë të qytetit, aktivizimi i Wi-Fi-së dhe vendosja e ujit të pijshë në disa vende, po ashtu edhe rregullimi i nje byfeje per lexues. Si dhe nje kërkesë nga bibloteka në fshatin Shalë qe te ritet numri i librave. Dhe e fundit rregullimi i lumit drenica.

Shahadije Bikliqi, tha se une e kam ngrite para disa muajve nje kallxim penal ndaj kryetarit te komunës, kerkoj nga organet kompetente te merren me këtë qeshtje.

Daut Azemi, tha se na jemi kuvend dhe i kemi të ndara kompetencat nga organet tjera, gjykata e ka punen e vet na punon tone.

Lulzim Rrsutemi, tha se pari është mirë te respektohet rregullorja e punes se kuvendit nga të gjithë dhe te behen pyetje jo diskutime me ore te tera e të bëhen debate të pa nevojshme. I kam disa çështje per ti ngritur e pra, ka qenë një kërkesë e banorve te fshatit Rubovc i Vogël per rrjetin e kanalizimit në fshat në disa lagje. E dyta banorët e fshatit Marevc kanë kërkuar qe te bëhet trotuari në drejtim te fshatit Llugaxhi, për shkak se po rrezikohen femijet e tyre. E treta, ne komisioni per keshilla te fshatrave po kemi telashe ne teren, qe te vendosen tabelat e shpalljve ne vendet publike neper fshatra per takimet ne fshatra. Dhe e fundit na si komison ne fshatra duhet te jemi me unik.

Ganimete Qeriqi, tha se mbase u bene shume urime, ajo qe une po du me uruar eshte se Nentori ka shume festa ka edhe ngjarje te rendesishme ,Kongresi i Alfabetit, pikrisht keto dite eshte perfshir edhe ditën e sotme 50 vjetori i Kongresit te drejshkrimit te Gjuhes Shqipe dhe formimi i Gjuhes se inisuar Kombetare.Kjo eshte ngjarja ma e rendesishme pas shpalljes se Pavaresisë,gjuha e unisuar kombetare eshte shtylla kryesore e unitetit ton kombetar

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se e falenderoj komisionin e fshatrave per punen e mire qe janë duke e bërë në teren. Ato qe i permendet do te merremi se bashku me nënkryetarin per njoftimet per keshilla.

Diamant Bytyqi nënkryetari i komunës tha, sa i përket rekomadimeve te komitetit per komunitete ne do ti kryejme ato disa vet disa ne bashkpunim ne donator. Ndresa te qendra e kultures aty banojne nje familje me kushte jo te mira. Trotuarin ne Gllogovc nuk e kemi parapar, sa i perket flamurit keshilli ka vendos vetem per dy flamuj ate kombetar dhe shtetëror. Sa i perket njoftimeve per keshilla te fshatrave une kam kerkuar qe te behen njoftim ma te mira nga zyra e informimit, por do ti vendosim prap edhe nje her edhe ne teren. Shetitorja ne Gadime do te vazhdoj pasi qe eshte projekt dy vjecar. Sa i perket reshjeve nuk kemi pas vershime po as telashe me uje te pijes. Presim me ru niveli i ujit dhe me punu te ura ne Rufc.Dukurite negative, policia me prokurorine kane mbajt disa takime ne shkolla. Marveshje të nënshkruar në mes të kryetarit te komunës dhe drejtorit të UBT-së nuk kemi gjet dhe nuk egziston nje e till e shkruar.Pjerrinat ne institucione ne shumicen e tyre ka qasje, por ne ato qe nuk ka do te ndërhyjme.Kanalizimi ne Rrubovc eshte i planifikuar ne vitin 2023

Rasim Hasani, tha se sa i perket perdorimit te drogava ne shkolla nga nxensit na duhet bashkpunimi i të gjithëve. Sa i perket unifromave në shkolla, shkollat e kanë keshillin e vet dejtues te shkolles dhe ata vendosin vet.

Shkelzen Hajdini tha se, renovimi ne QMF Shalë ka perfunduar,ne QMF Ne Gadime është duke vazhduar, ndersa ne QKMF, ju ka nderpre kontrata per shkak te mosrespektimit te kontrates.Na si drejtorat i shëndetësisë nuk kemi asnjë investim nga niveli qendror.

Anila Reqica-Llugiqi, tha se sa i perket biblotekes ne Shalë na para disa dite e kemi pajisur me 100 tituj te rinjë. Ndersa sa i perket Wi-Fi-së ne biblotekë të qytetit, aty ka interent edhe ne katin e pare dhe të dyte, por nuk ka ne sallat e leximit.Por nese eshte e nevojshme mund ta ndryshojme.

Alban Salihu, tha se une per shendetesi fola ne baze te deklarates se nje mjeku qe ka shenuar ne rrjetin social.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se ju kisha lut qe mos te hyni ne qeshtje personale.

Daut Azemi, ju kisha lut nga mbledhja e ardhshme te jeni te shkurte te beni vetem pyetje dy minuta dhe jo diskutime.

Pasi qe çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e12-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se kam verejtje pasi qe ata qe e kam diskutu une, eshte harruar krejt me mu shenu te pyetjet e antarëve te kuvendit.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e 12 e Kuvendit, me vërejtjet e cekura me larte, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 29 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 12-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Informatë mbi punën e deritanishme të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, Janar-Tetor 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rinor Muratit, kryesues i komitetit për Kulturë Rini dhe Sport, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se ju pergjoj per punen qe po e beni, por ajo qe me shqetësoj ju keni vizituar stadiumet por nuk e keni konstatuar qe gjendja e këtyre stadimeve është e rendë.

Daut Azemi, tha se kjo është vetëm një informatë e shkurtë, ndërsa roportet me te zgjeruara do te vijne ne Shkurt ose Mars

Lumturije Bytyqi, tha se po du me ditë cfar rekomandime i keni drejtuar Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport.

Arsim Jashari, tha se e pergjoj komnitetit per iniciativen, ajo qe është shqetsuese, qe janë mbi 40 ,OJQ në Lipjan, por ato nuk kanë burim financiar dhe per ndihme ju drejtohen institucioneve dhe per këtë nuk po mujnë me funksionu si duhet. Ju kisha lut mirrnu me rini po ashtu edhe vullnetarin e vitit zgjidhne me meritë.

Lulzim Rrustemi, tha se është një informatë e mirë dhe e përgëzoj komitetin për punën qe po e bëjnë, është mirë te konstatohet edhe gjendja faktike në teren, pasi qe stadiumet ne Magure dhe Dobrajë janë ne gejdje shumë te keqe dhe duhet te ketë rekomandime per këtë.

Daut Azemi, është mirë qe janë funksionalizuar këto komitete dhe po e bëjnë një punë të mirë, dhe tani do ti ndihmojne kuvendit ekzekutivit por edhe qytatarëve.

Rinor Murati, ne e kemi bërë këtë informatë me heret per shkak se e kemi edhe nje takim me OJQ per ditën e vullëtarizmit qe është 5 dhjetori, per punen qe kemi bërë si komitet dhe sygjërimet qe i kemi dhënë e sidomos per stadiumet.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

III

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj kryesuesi, hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se e kam thënë edhe ne KPF se ndarja e këtyre pozitave nuk është e drejtë pasi nuk është gjithëpërfshirëse, dhe aty na takon edhe neve një. Dhe ne do të bëjmë shkresë edhe në MAPL.

Daut Azemi, tha se këtë e kam bërë në bazë të udhëzimeve adminstartive në fuqi, dhe ne këtë e dërgojmë edhe në ministri për konfirmim.

Fadil Spahiu, tha se une mendoj qe nuk është respektuar ligji për vetqeverisje lokale, kuvendi duhet te reflektoj, dhe këtu nuk është reflektuar.

Daut Azemi, tha se ne kemi reflektuar, dhe ne i kemi 50% të votave dhe ne bazë të formulës së votës.

Alban Salihu, pse ne komitete tjera nuk është dikush prej zyrtarëve të drejtorateve ndërsa në këtë komitet po?

Daut Azemi, tha se une jam konsultuar me zyren ligjore dhe kështë ka qenë propozimi, dhe cfardo vlersimi qe na kthehet nga MAPL. Ne do ta respektojmë.

Albiona Tasholli, tha se ne grupi i LDK-së për anëtar të këtij komiteti e propozojmë: Majlinda Sylejamnin, Venhar Agushin dhe Fatime Krasniqin.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se me vjen mire qe kemi nje komitet te tillë dhe ne grupi i PDK-së për anëtarë të komitetit e propozojmë, Lumnije Sopa

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi e vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 2 kundër aprovoi vendimin.

IV

Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Shahadije Dragaçina tha se ne si grup propozojmë qe te jetë, nje pikë në dhjetor informatë për viktimat e dhunës nga këshilli komunal kordinues per viktimat e dhunës.

Arsim Jashari, tha se e mirëpres këtë plan, por kërkoj qe në muajin gusht mos të humben seancat, një plan i mirë dhe neve na ndihmon shumë.

Daut Azemi, tha se do te provojmë në vitet ne vazhdim me majtë. Une kam propozim qe te futet ne mars informata e komitetve funksionale

Arsim Jashari, tha se kam një propozim qe në muajin maj te jetë një vizitë në shtetet e rajonit

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet e cekura me lart, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi Vendim

V

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të ankesave.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi Vendim

VI

Propozim Rregullore për anulimin e rregullores për vendosjen,ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15.Nr.351/06-59184 e datës, 31.10.2022

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishtit , drejtor i DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se edhe në KPF e diskutuam këtë pikë, minsitria e ka per detyre veç me kqyre a është në bazë të ligjit. Ne si kuvend duhet me bërë një padi ndaj ministrisë pasi si shumë po na kthehen këto vendime.

Alban Salihu, tha se se jeni korrekt ne spjegim, une po mendoj qe nuk po kthehen keto vendime politikisht, pasi personi qe e ka kthi këtë shkresë i përket subjektit të AAK-së, ne bazë te fotove qe po i shoh qe i ka te publikuara ne rrjetet sociale.

Imri Semetishti, tha se kjo qështje ka shku nga zyra ligjore dhe ka shkuar drejtë, dhe nga minitria është kthyer jo drejtë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi rreguloren

VII

Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit , drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi Vendim

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 13,20

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi